



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.366/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Aleksander Belošević me venbanim në Mali i Zi, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Aleksander Belošević nga Mali i Zi me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të refuzimit të aplikacionit të tij që të regjistrohet si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.

### A r s y e t i m

Me datën 23.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Aleksander Belošević nga Mali i Zi, në të cilin pretendohet se shkak i apelit është refuzimi apo mos përbushja e kushteve për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës si dhe mos shpjegimi i arsyes së refuzimit nga KQZ-ja.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

#### Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1- 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr. 366/2021 më datën 25.08.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Abr.366/2021

Izborni Panel za Žalbe i Predstavke (IPŽP), u veću sastavljenom od sudija: Zyhdi Haziri, predsedavajući, Adnan Konuševci i Ferki Džaferi članovi, odlučujući o žalbi od strane **Aleksander Belošević** iz **Crne Gore**, podnetoj protiv Centralne Izborne Komisije (CIK), u vezi sa neuključivanjem u konačnu listu birača van Kosova, za lokalne izbore Republike Kosova koji će se održati 17.10.2021, na sednici panela održanoj 25.08.2021, doneta je sledeća:

#### ODLUKA

Odbija se kao neosnovana žalba od **Aleksander Belošević** iz **Crne Gore**, sa kojom se traži poništavanje odluke Centralne Izborne Komisije (CIK) zbog odbijanja aplikacije za registraciju u spisak birača van Kosova.

#### O b r a z l o ž e n j e

Dana **23.08.2021**, IPŽP je primio žalbu od **Aleksander Belošević** iz **Crne Gore**, u kojoj se navodi da je razlog za žalbu odbijanje ili neispunjavanje uslova za uključivanje u spisak birača van Kosova i neobrazloženje razloga za odbijanje od strane CIK-a.

Žalilac nije priložio nikakve dokaze u vezi sa navodima u žalbi.

Panel je, nakon razmatranja i procenjivanja svih žalbenih navoda, u smislu člana 117. stav 2. ZOI-a, utvrdio da:

#### Žalba je neosnovana

Panel je, nakon razmatranja slučaja, utvrdio da je žalba neosnovana jer podnosilac žalbe tokom prijave za registraciju za glasanje van Kosova nije ispunio tražene uslove na osnovu člana 5.1 tačka a) ZOI-a, gde je utvrđeno da: „*svako lice ima pravo glasa ako je registrovan kao državljanin Kosova u Centralnom Civilnom Registru Kosova*“, kao i odredba člana 3.1 Izbornog Pravila 03/2013 CIK-a koja predviđa da: „*birač sa pravnom podobnošću van Kosova može glasati na izborima ako je registrovan kao stalni stanovnik Kosova u Centralnom Matičnom Registru*“.

Iz spisa predmeta Panel je ocenio da podnosilac zahteva, prilikom podnošenja zahteva za registraciju za glasanje van Kosova, da njegov dosije nije bio potpun i nije ispunjavao kriterijume predviđenim u odredbama člana 5.1 tačka a) ZOI-a i Izbornog Pravila 03/2013 CIK-a i nije ispunio postavljene kriterijume.

Stoga, iz gore navedenih razloga i na osnovu odredbi člana 117. stav 3., 118. st. 1., 122. stav 1. tačka a) ZOI-a, kao i člana 11. stav 6. Pravila br. 02/15 IPŽP-a, odlučeno je kao u izreci ove odluke.

Izborni panel za žalbe i predstavke  
Abr. 366/2021 od 25.08.2021

Predsedavajući panela  
Zyhdi Haziri

**Pravni savet:** Žalba protiv ove odluke dozvoljena je Vrhovnom Sudu Kosova, u roku od dvadeset četiri (24) sata od trenutka prijema ove odluke.